

Pozita e sunetit të profetit (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në islam

1 - Suneti në terminologjinë islame

Falenderimi i takon Allahut, Zotit të Gjithësisë, bekimet dhe paqa qofshin mbi të dërguarin e Tij, vulën e pejgamberëve Muhamedin s.a.v.s. i cili ka thënë: " *Mua më është dhënë Kur'ani dhe diç e ngjajshme me të.*"¹

Sa kaq Allahu e ka dërguar profetin (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) me udhëzim dhe fe të drejtë si përgëzues dhe qortues në çdo kohë, i cili ka qenë kandil ndriçues për besimtarët që e kanë pasuar atë deri në kohërat e sotme dhe do të jetë deri sa të egzistoj jeta mbi këtë tokë, ai i cili ia ka kthyer sytë çdo të verbëri, i ka udhëzuar njerëzit në rrugën e drejtë dhe i ka mbrojtur nga humbja. i Dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ishte ai i cili kumtoi shpalljen si më mirë, e la umetin-popullin e tij në bardhësi të qartë, nata e së cilës është si dita e saj, dhe ka thënë: " *Unë me të vërtetë ju lë juve diçka në qoftë se ju i përmbaheni asaj nuk do të humbni, e ata janë libri i Allahut dhe suneti im.*" Po ashtu i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: " *Me të vërtetë kush do të jetoj pas meje do të shoh përçarje të mëdha për këtë u porosis të kapeni për sunetin tim dhe sunetin e prijësve të drejtë e të udhëzuar, kapuni për to fortë me dhëmballë dhe kini kujdes nga gjërat e shpikura, sepse çdo shpikje është bidat, e çdo bidat të çon në humbje.*"²

Pra tema jonë në këtë tubim të begatshëm me lejen e Allahut do të jetë për sunetin (rrugën e ndjekur, traditën) e profetit (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) si dhe për pozitën e saj të cilën e ka në islam. Në gjuhën arabe fjala "sune" do të thotë: "Rrugë", siç ka thënë Allahu në Kur'an: " **Pra ata nuk janë duke pritur vetëm se rrugën e të parëve të tyre.**" (Fatir:43) Që do të thotë nuk presin vetëm se rrugën, adetin e të parëve të tyre e cila ishte përgënjeshtim i rrugës së të dërguarve, prandaj edhe ligji i Allahut është ti dënon ata të cilët mohuan të dërguarin e Tij dhe i përgënjestruan ata. Gjithashtu i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: " *Ju me të vërtetë do të ndiqni rrugën e atyre që ishin para jush*"³. Pra rruga në hadithin e ka kuptimin rrugën e popujve që kanë qenë para jush.

Kurse suneti në terminologjinë islame është: çdo transmetim nga i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) qoftë fjalë apo vepër e tij, apo pëlqim nga ana e tij. Disa të tjerë kanë shtuar edhe cilësitë e tij, pra arijmë të nënkuptojmë se çdo gjë e cila transmetohet deri tek ne në mënyrë autentike nga i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) prej këtyre llojeve të cilat i cekëm më lartë llogaritet si sunet i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

2 - Suneti si shtylla – baza e dytë e referimit në islam

Sa i përket rëndësisë së tij dhe pozitës së tij në islam, pa dyshim se pozita e tij dhe vendi i tij në islam është shumë i madh pasi që suneti i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) vjen menjëherë e dyta pas Kur'anit Famëlartë, ngase baza e parë e fesë islame është libri i Allahut-Kur'ani Famëlartë të cilin ia ka zbritur të të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) udhëzim dhe sqarues për mbarë njerëzit. Kurse baza e dytë e islamit është suneti i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) pastaj çdo gjë nga argumentet që vjen prej këtyre të dyjave (Kur'anit dhe sunetit) nxiret nga këta. Pra bazat e argumentimit në islam janë këta të dyja: Libri i Allahut-Kur'ani dhe suneti i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), për këtë arsye porosisia e të dërguarit të Allahut drejtuar neve ishte: " *Unë me të vërtetë ju lë juve diçka, në qoftë se ju kapeni për ato nuk do të humbasni kurrë, e ato janë libri i Allahut dhe suneti im.*"⁴ Gjithashtu suneti i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është shpallje nga Allahu i Lartëmadhëruar siç ka thënë Allahu në Kur'an: " **Ai** (Muhamedi) **nuk flet nga mendja e tij, mirëpo** (çdo gjë që del nga goja e tij) **ajo është shpallje e cila i shpallet atij** (nga Allahu)." (Nexhm:3-4) Pra suneti është shpallje nga ana e Allahut e cila i është

¹ Ahmedi 4/130

² Ebu Davudi 4/20, Tirmidhiu 5/44, Ibnu Maxhe 1/15, Ahmedi 4/126

³ Buhariu 3/1274, Muslimi 4/2054

⁴ Malik-Muveta 2/899

shpallur të dërguarit tonë (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) nga ana e Allahut Fuqiptotë. Pra i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ua ka kumtuar njerëzve shpalljen se çka u lejohet atyre dhe çfarë ju ndalohej. Suneti gjithashtu është edhe shpjegim i Kur'anit, komentim i tij dhe sqarim i tij i cili është shpjegues decid i të përgjithshmeve të Kur'anit, veçues i të përgjithshmeve të Kur'anit, ndonjëherë është derogues i disa dispozitave të tij, ndonjëherë sjell disa dispozita shtesë të Kur'anit etj. Prej këtu shfaqet rëndësia e madhe e sunetit sepse është komentuesi i Kur'anit si dhe shpjeguesi i tij siç ka thënë Allahu në Kur'an: " **Ty ta kemi zbritur Kur'anin që tua shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre.**" (Nahl:44)

3 - Suneti shpjegues i detajizuar i Kur'anit dhe i kushteve të fese

Pra Allahu e ka zbritur Kur'anin kurse si shpjegues të tij e zgjodhi të dërguarin e Tij Muhamedin (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe shpjeguesi i tij është suneti i tij, siç ka thënë Allahu në Kur'an: " **çdo i dërguar e kemi dërguar në gjuhën e popullit të vet ashtu që tua shpjegoj atyre shpalljen.**" (Ibrahim:4) Gjithashtu edhe këtij umeti si umeteve tjera i ka ardhur i dërguari i tyre (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) që tua shpjegon atyre shpalljen. Shembull më praktik për këtë është se Allahu i Lartëmadhëruar na ka urdhëruar ta falim namazin në Kur'an, mirëpo nuk ka treguar numrin e rekateve të namazeve as të drekës, as të sabahut, as të ikindisë, as të akshamit e as të jatcisë, mirëpo vetëm ka urdhëruar në përgjithësi për faljen e namazit siç ka thënë në Kur'an: " **Fale namazin sepse me të vërtetë namazi të ndalon nga të shëmtuarat dhe të irituarat.**" (Ankebutë:45) Kurse në një vend tjetër thotë: " **Dhe nuk janë urdhëruar me diçka tjetër vetëm se ta adhurojnë Allahun me një adhurim të sinqert ndaj Tij, të largohen nga çdo besim i kotë, ta falin namazin dhe ta japin zekatin.**" (Bejine:5) Gjithashtu Allahu ka thënë në Kur'an: " **E në qoftë se ata (jobesimtarët) pendohen dhe e falin namazin, e japin zekatin...**" (Teube:5) Ajetet Kur'anore në këtë kontekst janë të shumta gjithashtu edhe ajetet të cilat urdhërojnë për faljen e namazit nuk tregojnë për kohën se kur fallen ato, kurse në Kur'an Allahu kohën e namazit e ka cekur në përgjithësi si në ajetin: " **Fale namazin kur zbret nga (zeniti) diellim, e deri në erësirën e natës dhe në agim, sepse vërtet leximi i Kur'anit në agim është i përcjellur.**" (Isra:78) Po ashtu Allahu ka thënë në Kur'an: " **Allahu lartësonie kur të vijë mbrëmja dhe kur të agojë mëngjesi, falenderimi i takon vetëm Atij në qiell dhe në tokë në mbrëmje dhe ditë.**" (Rrum:17-18) Pra siç shihet nga këto ajete ceket koha në përgjithësi kurse i ka caktuar kohërat e namazeve i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) duke u falur me shokët e tij dhe u ka thënë: " *Faluni si më keni parë mua duke u falur.*"⁵ Me këtë hadith na e bën të qartë numrin e rekateve në namaz, prandaj ne falemi ashtu siç është falur ai, pra e falim farzin e drekës katër rekat, kurse në udhëtim e shkurtojmë dhe e falim vetëm dy rekat. Akshamin e falim tre rekat madje çdo herë kur jemi në udhëtim apo jo, pra atë nuk e shkurtojmë, ndërsa jatcinë e falim katër rekat kur jemi vendas dhe e shkurtojmë në dy rekat kur jemi në udhëtim. Njëjtë sikurse akshami edhe sabahu ai është dy rekat dhe nuk shkurtohet, pra falet dy rekat kur jemi vendas dhe kur udhëtojmë. Kurse sa i përket kohës së namazeve edhe këto na i ka sqaruar i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) duke e falur sabahun në kohën e vet, drekën në kohën e vet, ikindinë në kohën e vet, akshamin në kohën e vet, madje të njëjtën e ka vepruar edhe me jatcinë, siç ka ardhur në hadithin autentik se Xhibrili (paqa e Allahut qoftë mbi të) i ka paraprirë imam të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në fillim të çdo namazi dhe në fund të çdo namazi ditën tjetër dhe pastaj i ka thënë: Koha e namazeve është ndërmjet tyre.⁶

Pra i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) na e ka treguar numrin e rekateve, mënyrën e faljes, kohët e namazeve, pra prej kësaj nënkuptohet se pa sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) nuk mundet asesi të kuptojmë se si falet namazi në mënyrën e duhur edhe pse në Kur'an kanë ardhur ajete të shumta për rëndësinë e namazit në mënyrë të përgjithshme. Pra Allahu edhe pse e ka obliguar në mënyrë të qartë namazin në Kur'an ai ia ka lënë në dorë shpjegimin e detajizuar të tij të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) pra kjo në të njëjtën kohë është sqarim gojor dhe sqarim në mënyrë veprorë. Në këtë mënyrë është argumentuar edhe Omer ibn Abdulazizi kur tek ai kanë ardhur një grup prej Hauarixhëve të cilët nuk e pranonin sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) si bazë më të cilën mund të argumentohet muslimani në islam për të debatuar, Omeri (Allahu e mëshiroftë) u tha:

⁵ Buhariu 1/226

⁶ ebu Davudi 1/107, Tirmidhiu 1/278

Allahu i Lartëmadhëruar na ka urdhëruar për ta falur namazin në Kur'an mirëpo parashtrohet pyetja si të falemi? Silleni një ajet nga Kur'ani i cili tregon për formën e faljes së namazit! Atëherë u habitën ky grup prej huarixhëve me këtë e si pasojë e kuptuan se suneti është ashtu sikurse Kur'ani, pra bazë prej bazave të argumentimit në fenë tonë.

Si shembulli i namazit, mund të përmendet si shembulli edhe çështja e zekatin. Allahu na ka urdhëruar në Kur'an për ta dhënë zekatin, mirëpo se në cilat pasuri jepet zekati? Këtë nuk mund ta kuptojmë vetëm se përmes sunetit, pra haditheve autentike të cilat na tregojnë se zekati jepen në: arë, argjend, drithra, pemë, në kafshë, mallit për tregti dhe se çfarë do lloj malli nuk jepet për zekat por jepet për mallrat fitimprurës në drithra, pemë, para, kafshë. Gjithashtu i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e ka treguar sasinë se në sa merit zekati, për shembull: zekati i drithrave dhe pemëve prodhimet të cilat dalin nga toka jepet një e dhjeta apo një e njëzeta, kjo pastaj mvaret nga ujitja. Për zekatin e arit dhe argjendit jepet një e katërta e një të dhjetës ose 2,5% e sasisë së përgjithshme, veçmas për çdo lloj floriri. Zekati i kafshëve tek dhentë në dyzet (40) kokë jepet një dele, pastaj kështu me radhë i ka treguar i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) edhe për kafshët tjera, ku për devet na ka informuar se jepet për pesë deve një dele, për dhjetë prej tyre jepen dy dele, në pesëmbëdhjetë jepen tre dele, për njëzet jepen katër dele kurse në njëzet e pesë deve jepet një deve njëvjeçare etj. Në të njëjtën kohë në hadithe kanë ardhur edhe argumentet se ne sa kohë jepet zekati për secilin produkt apo pasuri pasi që zekati nuk jepet derisa pasuria të flejë apo të qëndroj një vit, përveç pasurive bujqësore, zekati i të cilave nxiret kur ato vjelen, koren apo piqen për këtë është argument dhe fjala e Allahut: " **Ditën e korjes jepeni pjesën që është obligim.**"(Enam:141) E njejtja gjë vlen edhe për agjërimin e ramazanit i cili është shtyllë prej shtyllave të islamit, mirëpo rregullat e tij, çfarë e prish atë, mënyra e kompenzimit, për kë është obligim e për kë jo etj, gjithë këto hollësi i ka shpjeguar suneti i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

Po kështu edhe haxhi, Allahu e ka obliguar me Kur'an duke thënë: " **Për hirë të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është obligim për atë që ka mundësi udhëtimi tek Ajo.**"(Ali Imran:97) Sipas këtij ajeti Kur'anorë jep të kuptohet se vizita e Qabes është obligim, mirëpo koha se kur duhet kryer, forma e tij, dispozitat e tij, krejt këto kanë ardhur në hadithet që janë shënuar nga i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në haxhin e lamtumirës kur iu është drejtuar njerëzve me fjalët: " *Mereni haxhin nga une.*"

Shembulli i ngjajshëm janë edhe dispozitat mbi ata që kanë vepruar haramë për të cilat sheriati ka vendosur dënime, p.sh. Allahu ka urdhëruar në Kur'an ti pritët dora vjedhësit duke thënë: " **Vjedhësit dhe vjedhëses prejani duart.**"(El Maide:37) Mirëpo prerja e dorës në këto raste ka kushte dhe rregulla të cilat nuk janë cekur në Kur'an detajisht se në cilet raste pritët dora, kurse këto informacione shtesë për plotësimin e kësaj dispozite kanë ardhur në sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ku dora pritët vetëm pasi që vlera e vjedhur nga personi të kalojë më shumë se qereku i dinarit apo tre dirhem. Gjë e cila nuk është përmendur në Kur'an si dhe as vendin se prej ku pritët dora. Për këtë ka thënë i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) se pritët dora e djathtë deri në zogun e shuplakës së dorës.

Me përmendjen e këtyre shembujve nuk e kemi për qëllim studimin e komentimit të Kur'anit me sunet por këto shembuj i cekëm të jetë edhe njëherë e mirë e qartë se suneti është komentuesi i Kur'anit si dhe bazë e argumentimit në islam. Kështu që nga kjo kuptojmë se mos të ishte suneti i cili na i ka sqaruar këto dispozita neve do ta kishim të pamundshme që ti kryenim obligimet që Allahun na i ka vendosur në Kur'an, pra këto shembuj na e bëjnë të ditur edhe njëherë se sa e madhe është rëndësia e sunetit në islam.

Allahu i Lartëmadhëruar ka urdhëruar të respektohet i dërguari i Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në të njëjtën kohë na ka lajmëruar se ai i cili i bindet të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i është bindur edhe Allahut, pra thotë Allahu në Kur'an: " **Kush i bindet të dërguarit, i është bindur Allahut.**"(Nisa:80) Prej respektit të të dërguarit të Allahut(paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është edhe pasimi i sunetit të tij dhe veprimi sipas tij, thotë Allahu në Kur'an: " **Atë të cilin ua jep i dërguari mereni, e atë që ua ndalon i dërguari përmbajuni.**"(Hashr:7) Prej këtij ajeti kuptojmë se Allahu na ka urdhëruar të punojmë çdo gjë që na jep i dërguari i Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) qoftë prej urdhërave të ti qoftë prej ndalesave të tij, pra ti bindemi në mënyrën më të mirë të mundshme.

Në Kur'an shpesh Allahu urdhëron të respektohet i dërguari i Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në metoda të ndryshme, ndonjëherë Allahu respektin e të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e cek bashkë me respektin ndaj Tij siç thuhet në ajetin: "**O ju të cilët keni besuar bindjuni Allahut, bindjuni të dërguarit dhe prijësve tuaj.**" (Nisa:59), "**Thuaj: Bindjuni Allahut dhe të dërguarit .**" (Ali Imran:32) Pra ai ka bashkangjitur bindjen e Tij me bindjen ndaj të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

Ndonjëherë bindjen ndaj të dërguarit e ka cekur veçmas, siç thotë Allahu në Kur'an: "**Kush i bindet të dërguarit , Ai i është bindur Allahut.**" (Nisa:80) Gjithashtu thotë: "**Falni rregullisht namazin, jepni zekatin dhe respektojeni të dërguarin në mënyrë që të mëshiroheni.**" (Nur:56) Po ashtu ka thënë: "**Ne nuk dërguam asnjë të dërguar vetëm që me urdhërin e Allahut ti bëhet respekt** (nga njerëzit) **Atij.**" (Nisa:64)

Allahu i madhëruar po ashtu na urdhëron gjatë ndonjë konflikti ti referohemi Kur'anit dhe sunetit të të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) si gjykues në kundërshtimet tona, thotë Allahu në Kur'an: "**O ju që keni besuar bindjuni Allahut, bindjuni të dërguarit dhe prijësve nga ju e në qoftë se nuk pajtoheni për ndonjë çështje atëherë parashtrojeni atë tek Allahu** (Libri i Tij) **dhe tek i dërguari i Tij po që se besoni Allahun dhe ditën e fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë.**" (Nisa:59) Referim tek Allahu në ajet e ka kuptimin kthimin në Librin e Allahut-Kur'anin, kurse referim tek i dërguari i Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është kthimi tek personaliteti i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) gjatë jetës së tij, pra të pyetet ai, kurse pas vdekjes së tij kthimi tek suneti i dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Urdhëri i Allahut për t'ju referuar sunetit të të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është valide deri në ditën e gjykimit, kjo tregon se suneti i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është vendimtarë në ndonjë mosmarveshje e cila ndodh në këtë umet pa marë parasysh a është ndonjë dispozitë nga dispozitat e adhurimeve apo marrëdhënieve ndërnjerëzore, pra referencë e besimtarëve na qenka libri i Allahut-Kur'ani dhe suneti i të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Pra krejt kjo tregon se suneti është në vend të dytë menjëherë pas Kur'anit dhe se është bazë nga bazat esenciale të islamit pa të cilin nuk mund të paramendohen muslimanët të jenë të pamvarur nga ai në çdo kohë prej kohërave në të cilën jetojnë apo në çdo çështje prej çështjeve të tyre me të cilat ato përballen në këtë botë.

4 - Kërcënimi për ata që e kundërshtojnë sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të)

Allahu i Lartëmadhëruar i kërcënohet ashpër atyre të cilët e kundërshtojnë sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) duke thënë: "**Atë të cilën ua jep i dërguari mereni, dhe nga ajo e cila u ndalon përmbajuni dhe kini frikë Allahun, më të vërtetë Allahu dënon ashpër.**" (Hashr:7) Pre këtij ajeti nënkuptojmë se kush e kundërshton të dërguarin e Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në atë të cilën urdhëron Ai apo në atë për të cilën Ai (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ndalon, meriton dënimin e ashpër të Allahut. Thotë Allahu në Kur'an: "**E në qoftë se nuk të përgjigjen ty** (O Muhamed) **dije se ata vetëm se ndjekin epsheet e tyre.**" (Kasas:50) Gjithashtu i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "**Gjithësecili prej jush do të hy në xhenet përpos atij që nuk do.**- i thanë sahabët: E kush nuk don o i dërguari i Allahut të hy në xhenet?- tha: "**Kush më respekton mua ai do të hy në xhenet kurse kush nuk më respekton mua ai nuk do të hy në xhenet.**"⁷ Pra ai i cili e kundërshton të dërguarin e Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është kundërshtar i sunetit të tij dhe nuk dëshiron të hyjë në xhenet dhe për këtë njeri pa fije dyshimi vlen kërcënimi se ai rrezikon të dënohet në xhehenem.

Gjithashtu Allahu i Lartëmadhëruar ka thënë: "**Le të ruhen ata të cilët e kundërshtojnë rrugën e të dërguarit se ata do ti kaplon fitneja apo do ti godasë dënimi i hidhur.**" (Nur:63), "**Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë** (të asaj që të zbriti ty, e as asaj para teje) **derisa të mos zgjedhin ty, për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj** (pas gjykimit tënd) **të mos ndjejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe derisa të mos binden sinqerisht.**" (Nisa:65), "**O besimtarë, mos bëni asgjë para se të orientoheni në udhëzimet e Zotit dhe të dërguarit të**

⁷ Buhari 6/2655

Tij, kini kujdes Allahun, se me të vërtetë Allahu i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha." (Huxhurat:1) Nga këto ajete na bëhet me dije se janë në rrezik apo mund të ndëshkohen ose nuk janë besimtarë të vërtetë ata të cilët e kundërshtojnë rrugën e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), dhe atë për dy shkaqe:

1 – Zemrat e tyre ose i kaplon fitneja e cila këtu e ka kuptimin të devijojnë nga rruga e drejtë dhe të shkojnë në kufër pas besimit, pra prishen zemra e tyre si pasojë e mëkateve, humbje e rrugës dhe nuk mund të udhëzohen në rrugë të drejtë pas kësaj asnjëherë, sepse kanë kundërshtuar urdhërin e të dërguarit, ky denim është më i keq se ai cili vin pas.

2 – Në fjalën e Allahut "...**do ti godasë dënimi i hidhur.**", dënimi në ajet e ka kuptimin ose të dënohet me vdekje në këtë botë dhe sëmundje, si dhe shkatërim, humbja e cila është valide për jobesimtarët të cilët e kundërshtojnë rrugën e të dërguarit (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Ndërsa dënimi i dytë është ai i botës tjetër.

Sidoqoftë ai i cili kundërshton rrugën e të dërguarit (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) me qëllim për atë nuk ka alternativë tjetër vetëm se tu nënshtrohet të dy denimeve, dënimit në zemrën e tij-Allahu na ruajtë-si dhe dënim në trupin e tij apo në pasurinë e tij qoftë ajo me vdekje apo me humbje të pasurisë apo e shpirtit. Ky kërcënim i ashpër është për ata të cilët kundërshtojnë rrugën e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Thotë Allahu në Kur'an:" **Nuk i takon një besimtarit apo besimtares që kur Allahu të gjykon për diçka dhe i dërguari i Tij ata të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetërfarë. E kush e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, ai ka shkuar në një humbje të qartë.**"(Ahzab:36) Allahu i madhëruar në këtë ajet tregon për gjendjen e besimtarit, se kur ai kupton apo njohtohet me ndonjë dispozitë të ligjit të Allahut apo të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) nuk duhet dhe nuk mund ti shmanget asaj dispozite në qoftë se është obligative të punohet sipas asaj, pra besimtari i vërtetë i pranon dispozitat e Allahut dhe të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) me kënaqësi të madhe dhe zemër të hapur, pasi që ai e kupton se urdhërat e Allahut dhe të dërguarit të Tij janë të gjitha udhëzime për një jetë më të mirë. Prandaj ai i cili nuk vepron sipas tyre madje pretendon se i lejohet të bëjë zgjedhje tjetër përveç tyre atëherë ai ka humbur me një humbje të madhe dhe të qartë, ngase devijimi është e kundërta e udhëzimit dhe ashtu siç janë cekur në ajete 'humbja e qartë' apo 'devijimi i qartë'.

Po ashtu kërcënim për atë i cili kundërshton rrugën e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është edhe hadithi i atij njeriut i cili kundërshtoi hapurazi të dërguarin e Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Bëhet fjalë për atë person i cili hante me dorën e majtë, kur e pa i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e këshilloj të haj me të djathtën. E ai i tha se nuk mundet, e për këtë gënjeu. Pra ishte mendjemadhësia ajo e cila e shtijti të përgjigjet në këtë formë- atëherë i tha i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të):" *Mos mundsh asnjëherë.*" Kjo lutje e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e bëri që atij njeriut dora ti thahet deri në atë masë sa që a nuk kishte mundësi ta ngrinte deri tek goja e vet për tu ushqyer.⁸ E pa dyshim kjo është një argument i qartë për ata që kundërshtojnë urdhëresat e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) madje dënim ky i përshpejtuar qysh në këtë botë si dhe përfundim i keq i atij i cili kundërshton urdhërin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) me mendjemadhësi. Kurse e kundërta e këtij rasti është hadithi në të cilin transmetohet se i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) pa në dorën e një personit një unazë të arit dhe i tha:" *Mundet ndonjëri nga ju të mar një gacë prej zjarri dhe ta vendos në dorën e tij.*" Pastaj ia nxorri unazën nga dora dhe ia hodhi në tokë. Pas kësaj pasi u largua i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) nga ajo ndejë dikush nga të pranishmit i tha atij personi që ta mar unazën dhe të përfitoj nga ajo (duke e shitur) mirëpo ky besimtarë tha: Për Allahun nuk mar diçka të cilën e ka hedhur i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).⁹

Prandaj vëlla i dashur bën një krahasim mes këtyre dy rasteve, i pari kundërshtoi urdhërin e të dërguarit të Allahut duke u mbajtur mendjemadh, kurse besimtari i vërtetë ju bind në çast urdhërit të të dërguarit të Allahut (paqa

⁸ Muslimi 3/1599

⁹ Muslimi 3/1655

dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), pra ky është besimi i vërtetë dhe pasim i duhur i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Gjithashtu do të përmendim një rast tjetër se si shokët e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) pasuan sunetin e të dërguarit. Bëhet fjalë në fillimet kur u bë obligim falja e namazit pasi që u bë hixhreti në Medine besimtarët faleshin nga Bejtul Makdis (shtëpia e shenjtë në Palestinë). Sepse kështu i kishte urdhëruar Allahu, pas pak kohe Allahu i urdhëroi që kur të falen te kthehen drejt Mekes, pra Qabes dhe thotë: " **Dhe drejto** (gjatë faljes) **kokën tënde në drejtim të mesxhidul-Haremit** (Qabes)" (Bekare:144) Pra me këtë ajet u ndrua drejtimi i faljes së besimtarëve gjatë namazeve, kurse në fillim faleshin në drejtim të Bejtul Makdis duke punuar me urdhërin e Allahut i cili u ka thënë: " **Te Allahu janë lindja dhe permëndimi, Ai vë në rrugë të drejt atë të cilin do Ai.**" (Bekare:142) Pas kësaj zbriti urdhëri nga ana e Allahut se kibla është kah Qabja, kështu që disa nga sahabët në Medine ishin duke e falur namazin e ikindisë të drejtuar kah Bejtul-Makdis sepse nuk kishte aritur akoma lajmi për ndrimin e kibles. Gjatë faljes iu erdhi dikush nga sahabët dhe i lajmëroi se është ndruar kibla kurse ata ishin në namaz duke u falur, kështu që sahabët sa dëgjuan për lajmin në namaz e ndruan drejtimin prej nga Bejtul Makdis kah Qabeja duke pasuar në kulminacion urdhërin e Allahut pa parashtruar asnjë pyetje, pa pasur rezerva dhe pa kundërshtuar. Ky pra është besimi i vërtetë, muslimani posa të mer vesh për diçka se është urdhër i Allahut apo i dërguarit të Tij, ai menjëherë e zbaton atë pa kur farë dileme.

Ndërsa ata të cilët në zemrat e tyre ka sëmundje, dyftyrësi, Allahu për ta ka thënë: " **Disa mendjehetë nga njerëzit do të thonë çfarë i ktheu ata** (muslimanët) **prej kibles** (drejtimin) **në të cilin ishin ata** (kah Kudsi)." (Bekare:142) Këtu shihet se si një grup njerëzish parashtrojnë shumë pyetje dhe dilema pra nuk pasojnë urdhërat e Allahut në mënyrë të drejtpërdrejt, ndërsa besimtarët, grupi tjetër pasojnë dhe nuk kundërshtojnë e as nuk kanë dilema. Këta ishin disa shembuj të cilët tregojnë se çfarë vlere kishte suneti i profetit (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) tek gjeneratat e para të besimtarëve, veprat e tyre me të si dhe kënaqësia e gjykimit me të. Ngase ajo është baza e dytë prej llojeve të argumentimit në fenë islame, e vlerësonin atë, e respektonin me respekt të veçantë sepse ato ishin fjalët e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i cili nuk fliste nga hamendja porse çdo gjë që dilte nga goja e embël e Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ishte shpallje nga ana e Allahut dhe se në pasimin e rrugës së të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka bereqet dhe mirësi të panumërta për pasuesit e tij në këtë botë dhe në botën tjetër.

5 - Dobia gjatë bindjes ndaj urdhërave të të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)

Kjo është pozita e sunetit të të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) kështu që kush dëgjon diçka nga suneti i tij e ka obligim ti përgjigjet (nëse bëhet fjalë për farze dhe uaxhibate, pra detyrime sheriatike) dhe ta pason atë, madje sikurse ta ketë dëgjuar vet atë me veshët e tij nga goja e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), duke mos dyshuar aspak në të si dhe ta praktikon në vend atë sunet si dhe ta përhap tek njerëzit tjerë pasi për këtë ka thënë i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të): " *Allahu e ndriçoftë fytyrën e atij personi i cili dëgjon një hadith dhe ua kumton të tjerëve ashtu si e ka dëgjuar.*"¹⁰ Shiko vëlla i dashur se si i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka bërë nxitje në umetin e tij ta shpërndajnë sunetin e tij derisa të bëhet kijameti, po ashtu në haxhin e lamtumirës i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) iu drejtua të pranishmëve në hutben e Arafatit me këto fjalë: " *Ai i cili është present le tia kumton këto fjalë atij që nuk është present ngase ndoshta ai i cili nuk është present mund ta kuptoj më mirë fjalën time nga ai i cili e ka dëgjuar nga unë.*"¹¹ Këtu i ka urdhëruar të pranishmit të cilët kanë qenë present më të dërguarin e Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) tua transmetojnë këto fjalë atyre të cilët nuk janë present nga umeti i tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Për këtë shkakë besimtarët i kanë dhënë kujdes të madh sunetit të të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) si nga ana e ruajtjes së tij ashtu edhe nga ana e nxënies përmendësh dhe e kumtimit të tij. Gjithashtu ato i kanë bërë sunetit të të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) një klasifikim të cilin nuk e ka bërë asnjë umet para nesh për profetin e tij, prandaj nuk ka umet i cili është kujdesur më shumë për ruajtjen e fjalëve të të dërguarit të tij se sa umeti i Muhamedit (paqa

¹⁰ Tirmidhiu 5/34

¹¹ Buhariu 1/38, Muslimi 3/1305

dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Madje ky umet e ka mësuar sunetin-hadithet e tij përmendësh, ua kanë transmetuar të tjerëve gjeneratë pas gjenerate, i kanë shënuar hadithet e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), i regjistronin në mendje dhe në letër, i klasifikonin, i komentonin madje edhe nuk flenin vetëm e vetëm duke i shërbyer sunetit të të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Edhe pse në kohën e tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) i dërguari i Allahut ua ndaloi të shkruhen hadithet e tij duke thënë: " *Kush shkruan nga unë diçka le ta fshijë.*" Qëllimi i kësaj fjalë ishte të mos ngatërohen ajetet Kur'anore me hadithet e tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e të mos mendojnë njerëzit se hadithet e tij janë gjithashtu ajete Kur'anore. Por pas një kohe ai ua lejoi ti shkruajnë hadithet e tij, shembull për këtë ishte Abdullah Amr ibn Asi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) i cili shkruantë atë që dëgjonte nga i dërguari i Allahut prandaj dhe Abdullah Amr ibn Asi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) është një nga sahabët i cili transmeton shumë hadithe nga i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Shkaku se atë të cilën e dëgjonte nga i dërguari i Allahut (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) e shkruante ishte që mos të harohet, porse tek sahabët rëndësi më të veçantë ka pasur nxënja e haditheve përmendësh më shumë se të shkruarit e tyre, të cilët më vonë ua mësonin të tjerëve atë që e kishin mësuar ata vetë. Ata e kanë studiuar shumë hadithin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) madje për këtë dëshmojnë edhe raste të gjalla se si disa prej të parëve tanë të mirë kanë udhëtuar prej në Medine deri në Egjipt për të kërkuar apo dëgjuar një hadith të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) nga sahabiu i cili e kishte dëgjuar këtë hadith direkt nga i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe kjo ka ndodhur kështu sepse respekti i tyre ndaj sunetit të të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) ka qenë në nivelin më të lartë të mundshëm, madje për këtë duke mos u friksuar e as duke mos u ndaluar nga çfardo lloj vështirësie me të cilën janë përballur në këtë rrugë.

6 - Pozita që ka gëzuar suneti i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) tek të parët tonë të mire-selefus salih

Pas një periudhe të caktuar ishte pikërisht prijësi i drejtë Omer ibn Abdulazizi (Allahu e mëshiroftë) i cili filloi ti mbledh hadithet e të të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) në libra, pastaj më vonë ato filluan të mbidhen në libra të shumtë siç janë: Sahihet, Musnedet, Xhavamiet, Meaxhimet, etj krejt këto libra të posaçëm kishin në origjinë të vetmin qëllim dhe atë ruajtjen e sunetit të të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Sot madje i kemi të gatshme këto enciklopedi të mëdha në duart tona falenderimi i takon Allahut për këtë dhe krejt kjo si pasojë e asaj së sa mirë e kanë kuptuar të parët tonë të mirë rëndësine e sunetit të dërguarit të Allahut e si pasojë e kanë ruajtur në mënyrën më të mirë të mundshme nga shpikjet, devijimet, shtimet etj. madje duke ia kushtuar gjithë jetën e tyre hadithit që ajo të transmetohet deri tek ne në formën më autentike. Gjithashtu kjo shkencë i ka bërë ata që të shkruajnë libra që nuk ka mundur ti shkruaj dikush si ata në gjithë historinë e literatures dhe letërsisë, e as që ekzistojnë ekzemplare si ata vetëm se tek ne muslimanët, pastaj kanë vendosur edhe rregulla të ndryshme, decide, të rënda për ta pranuar hadithin e atij që e transmeton. Më pas i kanë veçuar edhe njerëzit të cilët kanë shpikur hadithe, duke i vërtetuar në shumë raste të tillët, i kanë veçuar ata persona të cilët nuk kanë pasur mundësi të mbajnë mend saktë hadithet, madje edhe pas cilës moshë të tyre ata nuk kanë mundur më të transmetojnë hadithe, i kanë veçuar ata persona të cilëve nuk u pranohen transmetimet pra nuk kanë qenë njerëz të besueshëm etj, madje kjo ruajtje e sunetit është në të njëjtën kohë edhe ruajtje e Librit të Allahut-Kur'anit siç ka thënë Allahu: " **Ne më të vërtet e zbritëm Kur'anin dhe Ne do ta mbrojmë atë.**" (Hixhr:9)

Pra ashtu sikurse e ka ruajtur Allahu Kur'anin ti shtohet apo ti hiqet atij diçka, ashtu e ka ruajtur edhe sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), pasi që ai është në të njëjtën kohë edhe komentuesi i Kur'anin Famëlartë. Kjo e gjitha si mëshirë për këtë umet nga ana e Allahut të Madhëruar i Cili i ka mbrojtur këta dy baza të mëdha të islamit, pra Kur'anin dhe sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të).

7 - Rreziku nga armiqtë bashkohorë të sunetit të të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të)

Në këtë kontekst do të cekim edhe grupet e devijuara të cilët janë shfaqur në këtë kohë me moton e tyre duke futur dyshime në sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) duke pretenduar se na majfton neve Kur'ani dhe se ne nuk kemi nevojë për sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) si sqarues i tij, duke u argumentuar me fjalën e Allahut në Kur'an: "**Nuk kemi lënë mangët në këtë libër asgjë.**" (Enam:38) Gjithashtu pretendojnë dhe thonë se suneti nuk është mutevatir-i transmetuar nga shumica e gjeneratave të hershme, pra siç është Kur'ani, duke shtuar se transmetojnë disa persona e persona, të pakët në numër, madje dikush prej tyre nuk është i besueshëm, dikush ka gënjyer, i kanë ngatëruar fjalët, i kanë komnetuar sipas dëshirave të tyre etj, kurse Kur'ani në të nuk ka kurfarë dyshimi e ne i largohemi të dyshimtës dhe e marim të sigurtën. Kështu thonë këta mendjelehtë-Allahu i poshtëroftë-mirëpo qëllimi i këtyre lloj njerëzve është ta çrrënjosin islamit nga ato trojë që është dominant dhe ta mangësojnë në të njejtën kohë atë nga përsosshmëria e tij, porse këtë e bëjnë me metoda të flliqta dhe kurthe të këqija. Duke mos patur mundësi tu thonë njerëzve direkt lëni islamit se nuk është për këtë kohë, apo lëni këtë shariat që pretendon kjo fe, detyrohen të përdorin rrugë dhe metoda indirekte të këtij lloji që në fund mund edhe të vonoj, por do të jap 'frytet e tij' pas një kohë të caktuar. Pretendimi i tyre që të shmanget nga referimi në çështjet fetare edhe në sunetin profetik është i logjikshëm për ta sepse me rënimin e njëres prej dy shtyllave bazë të islamit automatikisht rënohet edhe baza tjetër, pra komentimi dhe sqarimi i Kur'anit e si pasojë rezultati del se bëhët fjalë për një fjalë me mangësi dhe defekte e si pasojë ajo e humb ndikimin dhe vlerën e saj në atë vend dhe zëvendësohet nga ndonjë system tjetër jete. Kurse neve e dim mirë se çfarë vlerë të madhe ka suneti profetik madje edhe në shtyllat e fesë të cilat janë përmendur më parë, siç janë namazi, zekati, agjërimi, haxhi, e në qoftë se hiqet dorë nga referimi në sunetin profetik atëherë rënohen edhe kushtet e fesë islame të cilat janë edhe veprat që e karakterizojnë një musliman në veçanti dhe një shoqëri islame në përgjithsi. Duke mos përfunduar faktin se me heqjen dorë nga suneti profetik si referencë bazë në islam muslimani në të njejtën kohë nuk do të ketë mundësi të di çfarë është hallall apo çfarë është haram, ti njohë dispozitat tjera siç janë çështjet e trashëgimisë, martesës, tregtisë, jurisprodencës islame, udhëheqsisë apo edhe shumë çështje tjera që e përbëjnë përditshmërinë e besimtarit në jetën e tij siç janë obligimet familjare, bashkshortore etj. Mirëpo falenderimi i takon Allahut që i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) na ka parajmëruar para katërbëshjetë shekujsh nga dukuri të tilla duke thënë në hadithin e tij: "*Mos të vij dikush pas meje i mbështetur në karigen e tij e kur i vjen dikush me ndonjë hadith nga unë të thotë: Para nesh dhe juve e kemi librin e Allahut, e çfarë është në të hallall ne e bëjmë hallall, e çfarë është në të haram ne e bëjmë haram.*"¹² Pra duke pretenduar se nuk ka nevojë për sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të). Gjithashtu në shtojcën e këtij hadithi qëndron edhe fjala tjetër e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) e cila e sqaron atë që u tha më herët: "*Me të vërtet mua më është dhënë Kur'ani dhe diç e ngjajshme me të (suneti im)*"¹³ Ky hadith është muxhize-mrekulli e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) nga mrekullitë e shumta të tij, i cili gjithashtu na ka këshilluar të kemi kujdes prej tyre si dhe ti përmbahemi Kur'anit dhe sunetit sepse që të dyja janë nga ana e Allahut të Madhëruar ashtu siç thotë Allahu në Kur'an: "**Ai** (Muhamedi) **nuk flet nga hamendja e tij mirëpo ajo që ai flet është shpallje nga ana e Allahut që i shpallet atij.**" (Nexhm:3-4) Kurse pretendimi i tyre se Kur'ani është mutevatir e suneti nuk e gëzon këtë pozitë kjo është argument i kotë ngase suneti i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) nuk është diçka e rastësishme apo tregime si tregimet e letërsisë apo shpikësve të tjerë por është diçka e verifikuar në mënyrë shumë të saktë, madje ajo egziston në shkencat e fesë si shkencë në vete pra shkencë e hadithit e cila ka kushte , rregulla se si janë përzgjedhur hadithet e sakta nga ato jo të saktit.

E në këtë mënyrë kjo përbën një argument të qartë se si është ruajtur edhe hadithi i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) nga ana e Allahut nga çdo manipulues dhe shpikës në të gjithë kohrat derisa janë shkruar hadithet në librat bazë të hadithit (pra në përmbledhjet e njohura të haditheve) që janë munduar që të 'fusin duart' në shpalljen e Allahut. Suneti i të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) është ruajtur nga çdo hadith i shpifur , apo nga fjalët që janë shtuar në hadithe apo kanë dashur tia mveshin haditheve profetike. Është folur për transemtuesit në detaje për ata të besueshmit, për ata që kanë pasur memorje të saktë deri në një moshë të caktuar e pastaj e kanë humbur qartësinë e memories dhe kanë filluar të shtojnë apo të

¹² Ahmedi 4/130

¹³ Ahmedi 4/130

mangësojnë hadithet, për transmetuesit e dobët, për shpikësit e haditheve etj me radhe. Pra falenderimi i takon Allahut që shenjtëria e hadithit ka mbetur e pa cenuar nga dorët e shpikësve, rrenacakëve dhe atyre që kanë dashur ta prishin dhe rënojnë fenë përmes kësaj baze të rëndësishme të saj pasi që kanë qenë dijetarët e hadithit përmes të cilëve Allahu e ka ruajtur hadithin e të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) gjeneratë pas gjeneratë madje deri në kohët e sotshme dhe do të mbetet pa dyshim i tillë deri në ditën e shkatërimit të kësaj bote. Prandaj si pasojë e kësaj bie posht pretendimi i atyre të cilët mundohen të fusin dyshime dhe vesvese në sunetin e të dërguarit të Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) dhe krejt kjo si pasojë e mirësisë së madhe që ka lëshuar Allahu mbi umetin e Muhamedit (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) pasi që ky sunet pa dyshim se do të mbetet autentik në të gjithë kohrat dhe secili që mendon se do të arrij ta anashkalloj këtë bazë të fesë në mënyra të ndryshme nga mesi i besimtarëve nuk do t'ia arrij qëllimit. Madje ky person nëse është prej muslimanëve të manipuluar nga kjo propagandë dhe pasi që i shpejgohet e vërtetë ai përsëri ngul këmbë se kjo "teori e rrejshme" është e saktë atëherë ai person del nga feja dhe quhet jobesimtarë-kafir dhe kjo është shumë e qartë pasi që ky person e mohon bazën e dytë kryesore të fesë islame duke thënë ndryshe: Ne duhet ti bindemi vetëm Allahut dhe se nuk kemi nevojë ti bindemi të dërguarit të Tij (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të), kurse Allahu thotë në Kur'an: "**Atë të cilën ua jep i dërguari i Allahut mereni dhe atë që ai ua ndalon përmbajuni.**" (Hashr:7) Po ashtu i Lartëmadhëruar thotë në Kur'an: "**Ai** (Muhamedi) **nuk flet nga hamendja e tij mirëpo ajo që ai flet është shpallje nga Allahu që i shpallet atij.**" (Nexhm:3-4) Porse ne nuk duhet haruar dhe duhet te kemi kujdes se ka nga grupet e humbura në islam që kohë pas kohe lindin dhe perëndojnë, të cilët diturine e tyre e kanë marrë apo trashëguar nga libra të ideologjive të ndryshme që bien ndesh me rrugën e ndjekur nga i dërguari i Allahut (paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të) të cilët mundohen që si mbas kohës në të cilën jetojnë apo epsheve të tyre ta përshtasin fenë islame duke përdorur hadithe të dobëta apo edhe të shpifura, apo të flasin se cilët janë hadithe të sakta dhe cilat janë ta dobëta apo të shpikura duke mos asnjëfarë kompetencë në këtë drejtim. Dhe kjo sepse nuk plotësojnë as nga kriteret bazë të diturive të shkencës së hadithit që të flasin për këtë shkencë madhështore nga shkencat islame. Dhe këtu vlen të përmendet se këta grupe janë edhe më të rrezikshme se ai i pari pasi që padituria e grupit të parë është e qartë kurse këta grupet tjera pretendojnë se dinë shumëçka nga çështjet e fesë dhe maskohen me maskën e diturisë, kurse në të vërtetë edhe këta janë injorantë-të paditur nga ajo që flasin dhe veprojnë në lidhje me fenë.

Si çdo herë në fund e lusim Allahun e Lartëmadhëruar që të na begatoj me dituri të dobishme, ashtu siç na ka porositur Ai ta lusim Atë në lidhje me diturinë, në Kur'an ku thotë: "**Thuaj: O Allah ma shto dijen.**" (Taha:114) Apo siç na ka porositur i dërguari i Tij ta lusim Allahun duke thënë: "*O Allah o Zoti im më jep dije të dobishme, rrizk hallall dhe vepra të pranuar.*" E lusim Atë të na drejtoj drejt veprave mira, të na drejton në rrugën e drejtë, të na e bën të qartë të vërtetën që ta ndjekim atë, të na e bëj të qartë të pavërtetën që ti shmangemi asaj pasi që vetëm Ai është i Gjithëpushtetshëm ta bëj këtë, paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të dërguarin e Tij Muhamedin.